

**KONTRATE**  
**SHITJE KUOTASH**

Në Tiranë, sot në datën 8/Z/2021 (dymijë e njëzetë e një), jane te pranishem palet e meposhtme :

**Z.Giancarmine Battigaglia**, atësia Francesco, i datëlindjes 26/09/1977, lindur ne Crotone (Itali), madhor, me zotësinë e plotë për të vepruar, shtetas Italian, mbajtës i leternjoftimit me nr. personal YB5472050 referuar më poshtë si "Shitësi":

dhe

**Z.Leonardo Battigaglia**, atesia Francesco , i datëlindjes 06/07/1970, lindur në Crotone (Itali) dhe banues ne Itali, shtetas Italian, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i Leternjoftimit Karte Identiteti nr. Personal CA20116CW ; referuar më poshtë si "Blerësi".

**MEQËNËSE ekzistojnë faktet:**

*Z.Giancarmine Battigaglia, eshte ortak i vetëm i shoqërisë "Pagus Group" SHPK, shoqëri tregtare e të drejtës shqiptare, me NIPT(NUIS) L816240260, dhe zotëron 100% të kuotave të shoqërisë "Pagus Group" SHPK,*

*Z.Giancarmine Battigaglia, dëshiron ti shesë 50% te kontributeve qe ai zoteron ne shoqeri, ortakut të ri, Z. Leonardo Battigaglia, sipas kushteve të mëposhtme :*

*Z. Leonardo Battigaglia dëshiron të blejë nga Z.Giancarmine Battigaglia 50% te kuotave të zotëruara prej tij në shoqërinë "Pagus Group" SHPK, sipas kushteve te mëposhtme.*

*Nisur sa më sipër, palët, me vullnet të lirë dhe të plotë, hartojnë këtë "Kontratë shitje kuotash", me përmbajtjen si më poshtë :*

**Neni 1**

**Qëllimi i kontratës**

- Qëllimi i kësaj kontrate është transferimi i 50% të kontributeve qe Z.Giancarmine Battigaglia zoteron në kapitalin e shoqërisë "Pagus Group" SHPK, nga shitësi, tek blerësi.
- Kjo kontratë shërben për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe mënyrës së tranferimit të pronësisë dhe pagesës përkatëse lidhur me këtë transferim në përputhje me legjislacionin përkatës.

**Neni 2**

**Objekti i kontratës**

-Nëpërmjet kësaj kontrate, shitësi transferon në favor të blerësit 50% e kontributeve te zotëruara prej tij në shoqërinë "Pagus Group" SHPK, si më poshtë të përcaktuara:

- **Z.Giancarmine Battigaglia i shet 50 % te kontributeve qe zoteron ne shoqeri, ortakut te ri, Z.Leonardo Battigaglia;**

**Neni 3**

**Çmimi dhe menyra e pagimit**

-Të dyja palët kanë rënë dakort midis tyre që çmimi i shitjes të kontibuteve që shitesit transferon në favor të bleresit do të jetë në total konkretisht:

- **Z.Leonardo Battigaglia i ka paguar Z.Giancarmine Battigaglia , 50 Leke për kuoten që përfaqëson 50% te kapitalit të shoqërisë;**

-Po ashtu, të dyja palët deklarojnë se shuma e mësipërme i është shlyer përkatësisht Z. Giancarmine Battigaglia, përpara nënshkrimit të kësaj kontrate dhe se palet nuk kanë asnjë pretendim financiar kundrejt njeri-tjetrit.

#### **Neni 4**

##### **Përgjegjësitë dhe garancitë e palëve**

Shitësi, nëpërmjet kësaj kontratë shitje kuotash garanton si më poshtë:

- a) se është i vetmi titullar i ligjshëm i kontributeve që po transferohen me këtë kontratë shitje;
- b) se kontributet objekt shitje janë plotësisht të lira nga çdo barrë, detyrim, të drejta reale apo çdo lloj kufizimi tjetër.
- c) se transferimi i këtyre kontributeve në drejtim të blerësit është bërë në pajtim të plotë me ligjin tregtar në fuqi dhe dispozitat statutoare.
- d) se shoqëria ka zhvilluar aktivitetin e saj në konformitet me ligjin;

#### **NENI 5**

##### **Efektet e kontratës**

-Kjo kontratë ka fuqinë e ligjit për palët nga momenti i nënshkrimit të saj dhe mund të ndryshohet vetëm me marrëveshje me shkrim dy-palëshe.

-Kontrata ka efekt për palet e treta në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

#### **NENI 6**

##### **Informacioni konfidencial**

-Palet detyrohen të mbajnë konfidencial të gjithë dokumentacionin, të dhenat dhe çdo informacion të perfituar gjatë marrëdhënies së tyre në shoqëri apo dhe referuar marrëdhënies konkrete të krijuar me këtë kontratë.

#### **NENI 7**

##### **Transferimi i të drejtave**

-Menjëherë mbas nënshkrimit të paleve, kontrata do të depozitohet dhe regjistrohet nga blerësi pranë regjistrarit tregtar të QKB.

-Me nënshkrimin e kësaj kontrate, kapitali i shoqërisë "Pagus Group" SHPK do t'i përkasë dy ortakeve, si më poshtë:

- **Z. Giancarmine Battigaglia, zotërues i kuotës, që përfaqëson 50% të kapitalit të Shoqërisë "Pagus Group" SHPK, në vlerë kapitali 50 LEKË (pesedhjetë) lek;**
- **Z. Leonardo Battigaglia, zotërues i kuotes, që përfaqëson 50% të kapitalit të Shoqërisë "Pagus Group" SHPK, në vlerë kapitali 50 lek.**

#### **NENI 8**

##### **Ligji i aplikueshem, zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

-Kontrata është hartuar në përputhje me Legjislacionin tregtar në fuqi.

-Blerësi dhe shitësi angazhohen të bëjnë çdo përpjekje për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve apo konfliktet të mundshme që mund të krijohen midis tyre, lidhur me këtë kontratë nëpërmjet negociimeve të drejteperdrejta.

-Nese palet deshtojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve apo konflikteve midis tyre, çështja do të nënshtrohet juridiksionit gjyqësor përkatës.

#### **NENI 9**

##### **Dispozita përfundimtare**


-Kjo kontrate eshte hartuar ne 4 (kater) kopje, ne gjuhen Shqip me vlere te njejte ligjore nga nje per seicilen pale, e cila ju lexua me ze te larte e te qarte paleve nga Z.Bledar Brami ne gjuhen Italiane.

-Palet deklaruan se e degjuan, e kuptuan dhe meqenese kontrata eshte hartuar ne perputhje me vullnetin e tyre dhe ligjin, e nenshkruan personalisht dhe pa verejtje.

### PALËT KONTRAKTORE

#### SHITËSI

Z. Giancarmine Battigaglia



#### BLERËSI

Z. Leonardo Battigaglia

